

KONTRATË THEMELIMI E SHOQËRISË

“D&D Invest”

Sot më 23/10/2024 Anëtarët Themelues:

- Devis Çela, i datëlindjes 28/10/1999, lindur në Shkoder dhe banues në Tiranë, identifikuar me ID me nr. personal J91028093R, madhor, me zotësi të plotë për të vepruar.
- Erjon Marku, i datëlindjes 20/08/1988, lindur në Kruje dhe banues në Tiranë, identifikuar me ID me nr. personal I80820013K, madhore, me zotësi të plotë për të vepruar.

Të dy së bashku, me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë, të shprehur nëpërmjet kësaj kontrate themelimi, ranë dakort për krijimin e shoqërisë së thjeshtë “D&D Invest” me kushtet e mëposhtme:

NENI 1

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

“D&D Invest” themelohet si shoqëri e thjeshtë, bazuar në dispozitat 1074-1112 të kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

Shoqëria është person juridik privat.

Ky akt rregullon pozitën juridike të shoqërisë, marrëdhëniet e themeluesve, të organeve të saj, llojin e partneritetit, kohëzgjatjen e veprimtarisë së saj, duke u bazuar në legjislacionin shqiptar në fuqi që rregullon marrëdhëniet juridiko-civile.

NENI 2

EMRI I SHOQËRISË

Shoqëria është person juridik privat.

Emri i shoqërisë së thjeshtë është “D&D Invest” (*më poshtë referuar si “shoqëria”*).

NENI 3

SELIA E SHOQËRISË

Selia e shoqërisë do të jetë në adresën: **Kati pare i ndertesës Fondacioni “Zonja e Keshillit te Mire”, Rruga " Dritan Hoxha", Z. K. Nr. 8210, Nr.P. 1/256.**

NENI 4 OBJEKTI I VEPRIMTARISË

- Sherbime ne fushen e restoranteve dhe prodhimeve te tjera me karakter ushqimor, si dhe kryerja e sherbimeve delivery/catering(shperndarje), per prodhimet e mesiperme.

NENI 5

REGJIMI JURIDIK I SHOQËRISË

Shoqëria udhëhiqet nga parimet e ekonomisë së tregut dhe ka për qëllim, mes të tjerave, fitimin.

Shoqëria organizohet në formën e shoqërisë së thjeshtë. Veprimtaria e saj i nënshtrohet dispozitave të Aktit të Themelimit, Statutit si dhe dispozitave të legjislacionit në fuqi.

Me vendim unanim të mbledhjes së Asamblesë së Anëtarëve, shoqëria mund të ndryshojë regjimin juridik të saj në përputhje me dispozitat ligjore që do të janë në fuqi si dhe në përputhje të plotë me dispozitat e Aktit të Themelimit dhe Statutit të saj, duke bërë dhe përshtatjen e tyre sipas ndryshimeve përkatëse.

PJESA II

NENI 6

TË DREJTAT DHE DETYRIMET E ANËTARËVE

Anëtarët themelues kanë këto detyrime:

- Të regjistrojnë shoqërinë pranë QKB-së.
- Të derdhin kapitalin e nevojshëm për fillimin e aktivitetit të shoqërisë.
- Të sigurojnë mjediset e nevojshme për fillimin e aktivitetit, infrastrukturën e nevojshme, etj.
- Të sigurojnë kushtet për specializimin e pandërprerë të personelit ndihmës, të sistentëve, gjithnjë në funksion të rritjes së nivelit dhe cilësisë së veprimtarisë së ushtruar nga ana e shoqërisë.
- Të menaxhojnë marketingun dhe reklamën nëpërmjet mjeteve të ndryshme të informacionit.

Anëtarët mbajnë përgjegjësi për humbjen deri në kufirin e kapitalit të investuar.

Pasuritë e krijuara nga shoqëria gjatë aktivitetit të saj janë në pronësi të Anëtarëve, në raport me kapitalin themeltar të investuar prej tyre. Pasuritë mund të tjetërsohen, jepen me qira, dhe të lihen peng në hipotekë me miratimin e Mbledhjes se Asamblesë së Anëtarëve.

Anëtarët Themelues si dhe të gjithë anëtarët që do të pranohen si të tillë pranë shoqërisë duke përfshirë edhe bashkëpunëtorët e saj, detyrohen të ruajnë sekretin e themelimit dhe të veprimtarisë së shoqërisë.

Të punësuarit dhe të ngarkuarit me menaxhimin e shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen që të zhdëmtojnë shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

NENI 7

KOMPETENCAT E ANËTARËVE

Anëtarët kanë të drejtat e mëposhtme:

- Të administrojnë aktivitetin e shoqërisë konform objektit të veprimtarisë së saj.
- Të administrojnë vlerat e saj intelektuale dhe ekonomike-financiare.
- Të informohen për rezultatet ekonomiko-financiare në çdo fazë të aktivitetit të saj.
- Të marrin pjesë vetë ose me anë të përfaqësuesit në këtë aktivitet.
- Të térheqin të gjitha dokumentet kryesore të shoqërisë.
- Të largohen nga shoqëria dhe të shesin pjesën e kapitalit në bashkëpronësi në përputhje me kushtet që lejon statute dhe ligji.

Anëtarët në përputhje me Aktin e Themelimit, me Statutin dhe legjisacionin në fuqi kanë të drejtë që në të njejtën kohë të zotërojnë kuota/aksione në shoqëri të tjera tregtare.

Anëtarët kanë të drejtë të paraqesin propozime për shqyrtim para organeve të shoqërisë si dhe të emërojnë/shkarkojnë administratorin, të punësuarit, etj.

NENI 8

DETYSIMET E ANËTARËVE

Anëtarët kanë detyrimet e mëposhtme:

- Të derdhin kapitalin e nevojshëm për fillimin e akticitetit të shoqërisë.
- Të sigurojnë mjediset e nevojshme për fillimin e aktivitetit, infrastrukturën e nevojshme, etj.
- Të sigurojnë kushtet për specializimin e pandërprerë të personleit ndihmës, të asistentëve, gjithnjë në funksion të rritjes së nivelit dhe cilësisë së veprimtarisë së ushtruar nga ana e shoqërisë.
- Të menaxhojë marketingun dhe reklamën nëpërmjet mjetave të ndryshme të informacionit.

NENI 9

KOHËZGJATJA E SHOQËRISË

Shoqëria e thjeshtë do të ushtrojë aktivitetin për një periudhë kohe të pacaktuar.

NENI 10

KUSHTET EKONOMIKE TË SHOQËRISË

Aktiviteti operues i shoqërisë bazohet në kërkesat e ekonomisë së tregut. Veprimtaria ekonomike ndërtohet mbi parimet e kontabilitetit dhe pasqyrohet në bilancet e saj.

NENI 11

KAPITALI I SHOQËRISË

Kapitali themeltar i shoqërisë është i përbërë nga kontributi i anëtarëve themelues në vlerën 100,000 (njëqindmijë) lekë.

Kuotat janë me vlerë nominative. Kapitali përbëhet nga një kuotëa.

Kuota e shoqërisë është si më poshtë:

1. Z. Deviç Çela në masën 90 % të vlerës së kapitalit themeltar
2. Z. Erjon Marku në masën 10 % të vlerës së kapitalit themeltar

Vlerësimi i kapitalit themeltar është bërë nga anëtarët themelues me rastin e themelimit të kësaj shoqërie dhe nënshkrimit të kësaj kontrate themelimi, dhe është nënshkruar prej tyre.

NENI 12

TRANSFERIMI I KUOTAVE

Anëtarët mund të transferojën lirisht kuotat e zotëruara me një marrëveshje me shkrim.

NENI 13

ZMADHIMI DHE ZVOGËLIMI I KAPITALIT

Kapitali themeltar mund të zmadhohet ose zvogëlohet me vendim të të gjithë anëtarëve në përputhje me interesat e shoqërisë.

PJESA IV
NENI 14
ORGANET E SHOQËRISË

Organet drejtuese janë:

1. Asambleja e Anëtarëve.
2. Administratorët e Shoqërisë.

Mënyra e veprimitarës së tyre është përcaktuar në këtë statut.

Organi themelor i shoqërisë është Mbledhja e Asamblesë së Anëtarëve e cila mund të mblidhet në çdo kohë kur administratori/ët, ose vetë anëtarët e kërkojnë, duke lajmëruar 15 ditë përpara me shkrim.

Mbledhja e Asamblesë së Anëtarëve vendos për të gjitha problemet, me përjashtim të atyre që është vendosur ndryshe nga statuti.

PJESA V
NENI 15
ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

Anëtarët me marrëveshje ne përputhje me nenin 1080 të Kodit Civil bien dakort se:

Administrimi i shoqërisë do të kryehet nga një Administrator i cili do të veprojë i vetëm.

Administratori ka të gjitha të drejtat dhe fuqitë për drejtimin e shoqërisë, me qëllim që të arrijnë objektivat e saj, përveç atyre që ligji ia atribuon Asamblesë së Anëtarëve.


Administratori përfaqëson shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët si dhe para organeve të adminisratës dhe atyre gjyqësore.

Shoqëria merr përsipër detyrimet që rrjedhin nga aktet e organit administrative. Administratori është përgjegjës ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve për shkelje të statutit apo për dëme të shkaktuara gjatë administrimit të shoqërisë.

Administratori shkarkohet me vendim të të gjithë anëtarëve për shkaqe të justifikuara.

Personi i mëposhtëm emërohet administrator i shoqërisë për një periudhë 3 (tre) vjeçare, me të drejtë riemërimi:

1. Devis Çela, i datëlindjes 28/10/1999, lindur në Shkoder dhe banues në Tiranë, identifikuar me ID me nr. personal J91028093R, madhor, me zotësi të plotë për të vepruar.



NENI 16

KOMPETENCAT E ADMINISTRATORIT

Administratori ka këto kompetenca kryesore:

- Të miratojë planin e veprimtarisë së shoqërisë, dhe t'i paraqesë sipas rastit për miratim përfundimtar të Asamblesë së Anëtarëve.
- Të parashtrojë propozime përkatëse për Asamblenë e Anëtarëve, në lidhje me zmadhimin/zvogëlimin e kapitalit të shoqërisë.
- Të përfaqësojë shoqërinë në marrëdhënie me të tretët.
- Të përcaktojë strukturën organizative të shoqërisë dhe të krijojë organe të tjera të domosdoshme për realizimin e objektivave të shoqërisë.
- Të sigurojë zbatimin e përpiktë të vendimeve të Asamblesë së Anëtarëve.

PJESA IV

VITI FINANCIAR, BILANCI, FITIMI DHE HUMBJET

Neni 17

VITI FINANCIAR, PASQYRAT VJETORE FINANCIARE

Viti finanziar i shoqërisë zgjat 12 muaj dhe fillon ditën e parë të Janarit dhe mbaron ditën e tridhjetë e një-të të Dhjetorit. Viti i parë finanziar i shoqërisë fillon në datën e regjistrimit të shoqërisë dhe mbaron në datën e tridhjetë e një-të të Dhjetorit.

Në fund të çdo viti finanziar, administratori do të përmbushë detyrat e mëposhtme:

- Përgatitjen e një liste të detajuar të aseteve të shoqërisë dhe strukturën e tyre;
- Përgatitjen e bilancit të shoqërisë i cili pëershkruan situatën financiare të shoqërisë.
- Përgatitjen e llogarive të fitimit dhe humbjeve.

NENI 18

FITIMI I SHOQËRISË

Fitimi neto i shoqërisë shpërndahet në përputhje me pjesët e kapitalit në shoqëri. Fitimi i realizuar do të shpërndahet midis anëtarëve themelues. Fitimi është lirisht i transferueshëm brenda dhe jashtë shtetit shqiptar.

PJESA VII

NENI 19

MBYLLJA E SHOQËRISË, LIKUJDIMI

Kur vendoset mbyllja e shoqërisë, Mbledhja e Asamblesë së Ortakëve cakton likuidatorin që realizon likujdimin e saj. Shoqëria gjatë likujdimit mban anash emërtimit edhe emrin "Shoqëri në likujdim e sipër". Me miratimin e likujdimit shoqëria i jep fund veprimtarisë.

Kur anëtsrët pa shkaqe të arsyeshme nuk vendosin për aktet e mësipërme, Likuidatori dhe çdo person i interesuar mund të kërkojë nga Gjykata përfundimin e likujdimit.

Aktet e përfundimit të likujdimit, së bashku me llogaritë përkatëse përfundimtare, depozitohen në QKB për çregjistrimin e shoqërisë.

PJESA VIII

NENI 20

TË PËRGJITHSHME


Mosmarrëveshjet për statutin dhe kontratën e themelimit të shoqërisë do të zgjidhen nga vetë anëtarët me mirëkuptim dhe kur kjo nuk arrihet ato zgjidhen nga gjykata kompetente.

Gjykata kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Ky statut do të hartohet dhe nënshkruhet në 4 (katër) kopje.

ANËTARËT

Devis Çela



Erjon Marku

